

VENDIM
Nr. 254, datë 29.4.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 191, DATË 15.3.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË AGJENCISË PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL TË
GODINAVE DHE TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, NDODHUR NË ZONËN
KADASTRALE 8210, ME NUMËR PASURIE 3/74, ME SIPËRFAQE 5044.85 m², DHE
ME NUMËR PASURIE 3/183, ME SIPËRFAQE 1580.89 m²”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 191, datë 15.3.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe kudo në vendim, emërtimi “Agjencisë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal” zëvendësohet me “Fondit Shqiptar të Zhvillimit”.

2. Në titull, pas fjalëve “... me sipërfaqe 1 580.89 m² ...” shtohen fjalët “... dhe me numër pasurie 3/389, me sipërfaqe 56 m² ...”.

3. Në fund të pikës 1 hiqen fjalët “... me qëllim zhvillimin e projektit “Qendra multifunksionale e shërbimeve për sipërmarrjet e reja “Betahaus Tiranë” ...”.

4. Pas pikës 1 shtohen pikat 1/2 dhe 1/3, me këtë përmbajtje:

“1/2. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit të ndërtesës me sipërfaqe të përgjithshme 498.6 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë gjashtë) m², e cila pozicionohet në pasurinë nr. 3/74, me sipërfaqe 363.1 (treqind e gjashtëdhjetë e tre pikë një) m², në pasurinë 3/183, me sipërfaqe 79.5 (shtatëdhjetë e nëntë pikë pesë) m², dhe në pasurinë nr. 3/389, me sipërfaqe 56 (pesëdhjetë e gjashtë) m², ndodhur në zonën kadastrale 8210, Tiranë, sipas planrilevimit, bashkëlidhur këtij vendimi.

1/3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet ta tjetërsojë pronën ose ta japë në përdorim të tretët që nuk janë struktura apo subjekte në varësi të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.”.

II. Ngarkohen Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj